



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 09

Prishtinë, më 23 maj 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi – kryetar, Behar Selimi, Arsim Bajram, Halit Krasniqi, Haki Demolli, Armend Zemaj, Ardian Gjini, Ibrahim Makolli dhe Jasmina Živković.

Munguan: Mufera Šinik dhe Albulena Haxhiu.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Naim Hajdari – EULEX, Vlora Marmullakaj – EULEX, Petrit Hysaj – OSBE, Nexhmedin Sinani, Isuf Zejna – KDI, Lumnije Murati – ZPRK dhe Fixhrije Dragaj – praktikante.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni, Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18.04.2011;
3. Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit të Popullit të datës 29 prill 2011;
4. Shqyrtimi në parim i P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve;
5. Shqyrtimi në parim i P/L për ndihmë juridike falas;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 18. 04. 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18. 04. 2011 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Avokatit të Popullit të datës 29 prill 2011

Kryetari i njoftoi të pranishmit me shkresën e Avokatit të Popullit, që e ka njoftuar Komisionin me përmbajtjen e ankuesit NN, që është i njohur për institucionin e Avokatit të Popullit, i punësuar në aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës. Ankuesi në shkresën drejtuar Avokatit të Popullit ka kërkuar interpretim të dispozitave për shkak të paqartësive që ekzistojnë midis Ligjit të Punës, nr. 03 / L- 212 dhe të Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, nr. 03/ L-064. Ai vlerësoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e Komisionit për Legjislacion, prandaj propozoi t'i procedohet Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale.

Meqë nuk kishte vërejtje të tjera, Komisioni njëzëri e nxori këtë

PËRFUNDIM

Kërkesa e Avokatit të Popullit e datës 29 prill 2011 i procedohet Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie sociale për shqyrtim të mëtejme.

4. Shqyrtimi në parim i P/L për mbrojtjen e dëshmitarëve

Komisioni vlerësoi se Projektligji për mbrojtjen e dëshmitarëve, i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-15 për mbrojtjen e dëshmitarëve

5. Shqyrtimi në parim i P/L për ndihmë juridike falas

Komisioni vlerësoi se Projektligji për ndihmë juridike falas i plotëson kushtet e përcaktuara që të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në parim.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri u pajtua që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Të shqyrtohet dhe të miratohet në parim Projektligji nr. 04/L-17, për ndihmë juridike falas

6. Të ndryshme

Lidhur me këtë pikë nuk kishte diskutime.

Mbledhja përfundoi në orën 12:40

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Arben Gashi